

**Fondi i Investimit Albsig Standard  
ALBSIG INVEST Sh.a.**

**Pasqyrat financiare  
më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025**

**me raportin e Audituesit të Pavarur**

**Raporti i audituesit të pavarur****i-iii****Pasqyrat financiare:**

Pasqyra e pozicionit financiar	1
Pasqyra e fitim humbjeve dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e flukseve monetare	3
Pasqyra e ndryshimeve në kapital	4
Shënime për pasqyrat financiare	5 – 18
Skedule suplementare	I-III



RSM ALBANIA  
Rr.Skender Luarasi, sheshi  
Gjenerali  
Jozef San Martin, Pallati 3Hyrja 19,  
Tiranë, Shqipëri  
T: +355 69 706 6110  
[www.rsm.global/albania](http://www.rsm.global/albania)

## RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Drejtimin e Fondit të Investimit ALBSIG STANDARD dhe Shoqërinë Administruese të Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive Albsig Invest sh.a.

### Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Fondit të Investimit ALBSIG STANDARD ("Fondi"), që përfshijnë pasqyrën e të pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2025, si dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, si dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe të fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël materiale.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Fondit më 31 dhjetor 2025, dhe performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).


### Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Fondi në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës të Kontabilistëve Profesionistë (duke përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (Kodi i BSNEKP) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEKP.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

### THE POWER OF BEING UNDERSTOOD ASSURANCE | TAX | CONSULTING

RSM Albania SH.P.K is part of the RSM network and trades as RSM. RSM is the trading name used by the members of the RSM network. Each member of the RSM network is an independent accounting and consulting firm, which practices in its own right. The RSM network is not itself a separate legal entity in any jurisdiction.



## Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që Drejtimi i i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Fondit për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdij Fondin ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Fondit.


## Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të bazuar opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa një që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosdhënie e vetëdijshe e gjithë informacionit, keq-përfaqësim, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të lidhur me auditimin me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të cilat janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Fondit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël dhe informacioneve të lidhura shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- Duke u bazuar në evidencat e auditimit, nxjerrim përfundime mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga ana e drejtimit të parimit të vijimësisë si bazë kontabël, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse në aftësinë e Fondit për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit tek informacionet shpjeguese të pasqyrave financiare ose nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të ndryshojmë opinionin tonë. Përfundimet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të shkaktojnë që Fondi të ndalojë së vazhduari në vijimësi.



- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me Drejtimin dhe personat e ngarkuar me qeverisjen e Fondit, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

### Raport për Informacione të Tjera


Informacione të tjera përfshijnë informacione përgatitur ne përputhje me Ligjin Nr. 25\2018 Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, përveç pasqyrave financiare dhe këtij raporti të audituesit. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera të Fondit për vitin 2025 pritet të na vihen në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit. Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione. Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuara më lart kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me gabime materiale. Nëse bazuar në punën e kryer ne arrijmë në përfundimin se këto informacione përmbajnë gabime materiale, atëherë ne duhet të raportojmë për këtë fakt.

Elona Bisha

Auditues Ligjor

RSM Albania

Tiranë, 30 prill 2026



**ALBSIG INVEST SHA**  
**FONDI I INVESTIMIT ALBSIG STANDARD**

Pasqyra e Pozicionit financiar më 31 dhjetor 2025  
(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
<b>Aktivet</b>			
Paraja dhe ekuivalentet e saj	5	34,020,574	29,538,145
Aktive financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes	6	261,300,378	235,215,820
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>295,320,952</b>	<b>264,753,965</b>
<b>Detyrimet</b>			
Të pagueshme ndaj Shoqërisë Administruese	7	248,969	223,182
Të pagueshme ndaj Bankës Depozitare	8	42,325	37,941
Detyrime të tjera	9	168,490	168,118
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>459,784</b>	<b>429,241</b>
<b>Aktivet neto që i atribuohen kuotambajtësve kuotave</b>			
		<b>294,861,168</b>	<b>264,324,724</b>
Numri i kuotave të emetuara		243,946	229,400
<b>Aktivet neto ndaj një kuote</b>		<b>1,209</b>	<b>1,152</b>

Pasqyrat financiare u aprovuan nga Këshilli i Shoqërisë Administruese "Albsig Invest Sh.a", më 30 prill 2026 dhe janë firmosur nga:

**Z. Irfan LAMI**

Drejtor Finance

Albsig Sh.a

**Z. Elton KÖRBI**

Administrator i Përgjithshëm

Albsig Invest Sh.a

Shënimet shpjeguese në faqet 5-18 janë pjesë e pandarë e këtyre pasqyrave financiare.



**ALBSIG INVEST SHA**  
**FONDI I INVESTIMIT ALBSIG STANDARD**

Pasqyra e fitim humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025  
 (Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Të ardhura nga shitja e instrumenteve financiare	10	-	14,945
Të ardhura nga interesi të llogaritura duke përdorur metodën e interesit efektiv	11	13,757,166	13,270,559
Të ardhura të tjera		3,363	136,550
<b>Totali i te ardhurave</b>		<b>13,760,529</b>	<b>13,422,054</b>
<b>Shpenzimet</b>			
Humbje nga shitja e instrumenteve financiare	10	191,562	258,262
Tarifa e Shoqërisë së Administrimit	12	2,850,401	2,575,205
Tarifa e Bankës Depozitare	13	509,926	478,396
Shpenzime të tjera	14	298,850	285,402
<b>Totali i shpenzimeve</b>		<b>3,850,739</b>	<b>3,597,265</b>
<b>Të ardhura neto</b>		<b>9,909,790</b>	<b>9,824,789</b>
Ndryshimi në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura në vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes	6	3,180,745	15,092,397
<b>Rritja në aktivet neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave</b>		<b>13,090,535</b>	<b>24,917,186</b>

Shënimet shpjeguese në faqet 5-18 janë pjesë e pandarë e këtyre pasqyrave financiare.

**ALBSIG INVEST SHA**  
**FONDI I INVESTIMIT ALBSIG STANDARD**

Pasqyra e flukseve të parasë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025  
 (Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
<b>Rrjedha e parasë nga aktiviteti operacional</b>			
Rritja në aktivet neto që i atribuohen kuotambajtësve		13,090,535	24,917,186
Të pagueshme ndaj Shoqërisë Administruese	7	25,787	18,294
Të pagueshme ndaj Bankës Depozitare	8	4,384	3,110
Detyrime të tjera	9	372	(99,575)
Aktive financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes	6	(26,084,558)	(82,999,545)
<b>Rrjedha e parasë neto nga aktiviteti operacional</b>		<b>(12,963,480)</b>	<b>(58,160,530)</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktiviteti financiar</b>			
Kontribute nga lëshimi i kuotave		29,123,550	15,996,837
Tërheqje e kuotave		(11,677,641)	(27,101,371)
<b>Rrjedha e parasë neto nga aktiviteti financiar</b>		<b>17,445,909</b>	<b>(11,104,534)</b>
<b>Rritje në para dhe ekuivalentet e saj</b>		<b>4,482,429</b>	<b>(69,265,064)</b>
Paraja dhe ekuivalentet e saj në fillim të periudhës		29,538,145	98,803,209
<b>Paraja dhe ekuivalentet e saj në fund të periudhës</b>		<b>34,020,574</b>	<b>29,538,145</b>

Shënimet shpjeguese në faqet 5-18 janë pjesë e pandarë e këtyre pasqyrave financiare.

**ALBSIG INVEST SHA**  
**FONDI I INVESTIMIT ALBSIG STANDARD**

Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto më 31 dhjetor 2025  
 (Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Numri i kuotave	Aktivet	Vlera e aktiveve për kuotë
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2023</b>	<b>239,495</b>	<b>250,512,072</b>	<b>1,046</b>
Kontribute në kuota gjatë vitit	14,635	15,996,837	1,093
Tërheqje e kuotave gjatë vitit	(24,730)	(27,101,371)	1,096
Rritja në aktivet neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave	-	24,917,186	-
<b>Aktivet neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave</b>	<b>229,400</b>	<b>264,324,724</b>	<b>1,152</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2024</b>	<b>229,400</b>	<b>264,324,724</b>	<b>1,152</b>
Kontribute në kuota gjatë vitit	24,222	29,123,550	1,202
Tërheqje e kuotave gjatë vitit	(9,676)	(11,677,641)	1,207
Rritja në aktivet neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave	-	13,090,535	-
<b>Aktivet neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave</b>	<b>243,946</b>	<b>294,861,168</b>	<b>1,209</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2025</b>	<b>243,946</b>	<b>294,861,168</b>	<b>1,209</b>

Shënimet shpjeguese në faqet 5-18 janë pjesë e pandarë e këtyre pasqyrave financiare.

## **ALBSIG INVEST SHA**

### **FONDI I INVESTIMIT ALBSIG STANDARD**

---

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025  
(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

#### **1. Informacion i përgjithshëm**

Fondi i Investimit Albsig Standard (tani e tutje do i referohemi si “Fondi”) u krijua në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 10198, datë 10 dhjetor 2009 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive” (tani e tutje do i referohemi si “Ligji”) dhe u licencua nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (tani e tutje do i referohemi si “AMF”), me vendimin numër 255, date 30 dhjetor 2019. Në qershor të vitit 2020, u miratua ligji i ri nr. 56/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”.

Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive është Albsig Invest sh.a., (tani e tutje do i referohemi si “Shoqëria Administruese”), e cila është një shoqëri aksionare, e themeluar në tetor të vitit 2019, dhe e licencuar nga AMF, me vendimin numër 210, datë 22 nëntor 2019.

Adresa e regjistruar e Shoqërisë Administruese dhe e Fondit të Investimit Albsig Standard është Bulevardi “Bajram Curri”, Albsig HQ, Kati 16, Tiranë, Shqipëri.

Fondi i Investimit u krijua nëpërmjet kontributeve në kuota nga të gjithë anëtarët e tij, dhe zotërohet plotësisht nga ata kontribues mbajtës të kuotave. Fondi është një fond investimesh kryesisht i përfshirë në letra me vlerë të emetuara nga Qeveria Shqiptare.

Banka e Tiranës është banka depozitare e Fondit e miratuar nga AMF. Banka depozitare bazuar në kërkesat e Ligjit, bën të mundur ruajtjen e aktiveve të Fondit në përputhje me kërkesat e Shoqërisë Administruese.

#### **2. Bazat e përgatitjes**

##### **a) Deklarata e përputhshmërisë**

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”) dhe interpretimet e përshtatura nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK). Ato u autorizuan për lëshim nga Këshilli i Administrimit të Fondit më 30 prill 2026.

##### **b) Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, me përjashtim të aktiveve financiare të mbajtura me vlerën e drejtë, të cilat maten në vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes.

##### **c) Monedha funksionale dhe ajo e prezantimit**

Pasqyrat financiare janë paraqitur në monedhën shqiptare “Lek”, që është monedha funksionale dhe prezantuese e fondit dhe të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek përveçse kur është shprehur ndryshe.

Monedha funksionale është monedha e ambientit primar ekonomik në të cilin Fondi vepron. Investimet dhe veprimet e Fondit kryhen në Lek. Shpenzimet (duke përfshirë tarifat për Shoqërinë Administruese, Bankën Depozitare dhe të tjera) kryhen në Lek. Për rrjedhojë Këshilli i Administrimit ka përcaktuar Lekun si monedhën funksionale të Fondit.

**ALBSIG INVEST SHA**  
**FONDI I INVESTIMIT ALBSIG STANDARD**

---

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025  
(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

**2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)**

**d) Parimi i vijimësisë**

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të vijimësisë dhe nuk përfshijnë ndonjë rregullim të vlerës kontabël dhe klasifikimit të aktiveve, detyrimeve dhe shpenzimeve të raportuara që përndryshe mund të kërkohen nëse baza e parimit të vijimësisë nuk do të ishte e përshtatshme.

Drejtimi i Fondit beson se ka aktive të mjaftueshme dhe se ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar qëndrueshmëri dhe zhvillim të biznesit në kushtet aktuale.

**e) Gjykimet kontabël dhe vlerësimet**

Përgatitja e pasqyrave financiare, kërkon që drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe në vlerën e mbartur të aktiveve dhe detyrimeve, si edhe të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara. Vlerësimet dhe supozimet e lidhura me to rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën kur këto vlerësime rishikohen dhe gjithashtu në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

Shoqëria ka kryer disa teste të rezistencës, ecurinë e likuiditetit ndikimin e normave të interesit dhe ka analizuar edhe skenarët e mundshëm për Fondin e Investimit.

**3. Politikat kontabël të rëndësishme**

**Standardet dhe interpretimet e mëposhtme zbatohen për herë të parë në periudhat e raportimit financiar që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2025:**

Disa standarde të cilat janë bërë efektive nga 1 janar 2025 dhe rrjedhimisht kanë hyrë në fuqi, nuk kanë ndikim të rëndësishëm në rezultatin apo pozicionin financiar të Shoqërisë.

**a) Standardet e reja që mund të adoptohen më herët**

- Mungesa e shkëmbyeshmërisë (Ndryshimet në SNK 21)

**b) Standarde dhe interpretime të reja, ende të paadoptuara**

- Ndryshime në Klasifikimin dhe Matjen e Instrumenteve Financiare (Ndryshime në SNRF 9 dhe 7)
- SNRF 18 "Prezantimi dhe shpalosja në pasqyrat financiare"
- SNRF 19 'Filiale pa Përgjegjësi Publike: Dhënia e informacioneve shpjeguese

Këto ndryshime nuk pritet të kenë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare në periudhën e aplikimit fillestar dhe për këtë arsye shpalosjet nuk janë bërë.

**ALBSIG INVEST SHA**  
**FONDI I INVESTIMIT ALBSIG STANDARD**

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025  
(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

**3. Politikat kontabël te rëndësishme (vazhdim)**

**a. Transaksionet në monedhe të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në Lek me kurset e këmbimit në datën e transaksioneve. Aktivët dhe detyrimet jo-monetare të mbajtura në monedhë të huaj në datën e raportimit nuk rivlerësohen në fund viti dhe maten me koston e tyre historike (konvertuar në monedhën funksionale me kursin e asaj date) përveç, aktiveve dhe detyrimeve jo-monetare të matura me vlerën e tregut të cilat konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës kur u përcaktua vlera e tyre e tregut.

Fitimi apo humbja nga kurset e këmbimit, që rezultojnë nga kryerja e transaksioneve të tilla si dhe nga përkthimi i aktiveve dhe detyrimeve monetare të mbajtura në monedhë të huaj, njihet në fitim ose humbje, përveç instrumenteve financiare që mbahen me VDFH, të cilat njihen si një komponent i të ardhurës neto nga instrumentet financiare në VDFH.

**b. Instrumentet financiare**

**i. Njohja dhe matja fillestare**

Fondi fillimisht njihet në mënyrë të rregullt, transaksionet me aktivet financiare dhe detyrimet financiare në vlerën e drejtë nëpërmjet fitim humbjes ("VDFH") në datën e tregtimit, e cila është data kur Fondi bëhet palë kontraktuale e instrumentit. Aktivët e tjera financiare dhe detyrimet financiare njihen në datën në të cilën ato krijohen. Një aktiv financiar ose një detyrim financiar matet në fillim me vlerën e drejtë plus koston e transaksionit, në rastin e elementëve të përcaktuar jo me VDFH, që i ngarkohen drejtpërdrejtë blerjes ose emetimit të tij.

**ii. Klasifikimi dhe matja e mëpasshme**

**Klasifikimi i aktiveve financiare**

Në njohjen fillestare, aktivi financiar klasifikohet si i matur me koston e amortizuar ose me VDFH. Një aktiv financiar matet me koston e amortizuar nëse përmbush njëkohësisht dy kushtet si më poshtë si edhe nuk është i destinuar me VDFH:

- mbahet në një model biznesi i cili ka për qëllim të mbajë aktivet për të mbledhur flukset e parasë; dhe
- rrjedha e parasë, lind në data të përcaktuara, sipas kushteve kontraktuale, të cilat janë, vetëm pagesa principali dhe interesit (VPPI).

Të gjitha aktivet e tjera financiare të Fondit maten me VDFH.

**Vlerësimi i modelit të biznesit**

Në gjykimin e tij mbi vlerësimin e objektivave të modelit të biznesit në të cilin mbahet një aktiv, Fondi merr parasysh të gjithë informacionin relevant mbi mënyrën se si biznesi po administrohet duke përfshirë:

- politikat dhe objektivat e përcaktuara të portofolit dhe zbatimi i tyre në praktikë. Në veçanti, nëse strategjia e drejtimit fokusohet në përfitim dhe të ardhurave kontraktuale nga interesi, mbajtjen e një profili të veçantë të normës së interesit, përputhjen e kohëzgjatjes së aktiveve financiare me kohëzgjatjen e detyrimeve që financojnë këto aktive ose realizimin e flukseve monetare nëpërmjet shitjes së aktiveve;
- rreziqet që ndikojnë në performancën e modeleve të biznesit;
- frekuencën, volumin dhe kohën e shitjeve në periudhat e kaluara.

Fondi ka dy modele biznesi.

*Modeli i biznesit mbajtje deri në mbledhje:* ky model përfshin parandë dhe ekuivalentet e saj, dhe të arkëtueshme. Këto aktive financiare mbahen në mënyrë që të mblidhen flukset kontraktuale të parasë.

*Model tjetër biznesi:* kjo përfshin letrat me vlerë të qeverisë shqiptare. Këto aktive financiare menaxhohen dhe performanca e tyre vlerësohet, mbi bazën e vlerës së drejtë, meqenëse ndodh shpesh tregtimi i tyre në treg.

**ALBSIG INVEST SHA**  
**FONDI I INVESTIMIT ALBSIG STANDARD**

---

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025  
(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

**3. Politikat kontabël te rëndësishme (vazhdim)**

**Riklasifikimet**

Aktivitetet financiare nuk riklasifikohen pas njohjes së tyre fillestare, përveç nëse Fondi ndryshon modelin e tij të biznesit për menaxhimin e aktiveve financiare. Në këtë rast të gjithë aktivitetet financiare që ndikohen, do të riklasifikohen në datën e parë në periudhën e parë raportuese që vijon ndryshimin e modelit të biznesit.

**Matja e mëpasshme e aktiveve financiare**

**Aktivitetet financiare me VDFH**

Këto aktive financiare maten më pas me vlerën e drejtë. Fitimet ose humbjet neto, duke përfshirë të ardhura ose shpenzime nga interesi, ose kurset e këmbimit, njihen në fitim humbje, në të ardhura neto nga instrumentet financiare në VDFH, në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Letrat me vlerë të Qeverisë Shqiptare përfshihen në këtë kategori.

**Aktivitetet financiare me kosto të amortizuar**

Këto aktive maten më pas me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Të ardhurat nga interesi njihen në të ardhura nga interesi sipas metodës së interesit efektiv, fitim humbjet nga kurset e këmbimit njihen në fitim humbje neto nga kurset e këmbimit, dhe humbjet nga zhvlerësimi njihen në humbje nga zhvlerësimi i instrumenteve financiare në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo fitim ose humbje në njohjen fillestare gjithashtu njihet në fitim humbje. Paraja dhe ekuivalentet e saj përfshihen në këtë kategori.

**Detyrimet financiare – Klasifikimi, matja e mëpasshme dhe fitim ose humbjet**

Detyrimet financiare klasifikohen dhe maten me kosto të amortizuar ose në VDFH. Një detyrim financiar klasifikohet si VDFH nëse ai klasifikohet si i mbajtur për tregtim, nëse ai është një derivativ ose nëse është i destinuar si i tillë në njohjen fillestare. Detyrimet financiare në VDFH maten me vlerën e drejtë dhe fitim humbjet neto, duke përfshirë edhe ndonjë interes, njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Detyrime të tjera financiare maten më pas me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet nga interesat dhe fitim ose humbjet nga kursi i këmbimit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo fitim ose humbje nga ç'regjistrimi njihet po ashtu në pasqyrën e të ardhurave ose shpenzimeve.

**Detyrimet financiare me VDFH**

Këto janë instrumente financiarë të mbajtur për tregtim.

**ALBSIG INVEST SHA**  
**FONDI I INVESTIMIT ALBSIG STANDARD**

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025  
(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

**3. Politikat kontabël te rëndësishme (vazhdim)**

**Detyrimet financiare me kosto të amortizuar**

Këto janë detyrimet me Shoqërinë Administruese, Bankën Depozitare dhe detyrime të tjera.

**iii. Matja e vlerës së drejtë**

‘Vlera e drejtë’ është çmimi që do të arkëtohej nga shitja e një aktivi ose që do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut, në datën e matjes në një treg kryesor ose, në mungesë të tij, në tregun më të favorshëm tek i cili Fondi ka qasje në atë datë.

Kur është e mundur, Fondi mat vlerën e drejtë të një instrumenti financiar duke përdorur çmimin e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Një treg quhet “aktiv”, në qoftë se transaksionet për aktivin ose detyrimin ndodhin me frekuencë dhe vëllim të mjaftueshëm për të siguruar informacion mbi çmimet në vazhdimësi.

Nëse nuk disponohet një kuotim çmimi në një treg aktiv, atëherë Fondi përdor teknika vlerësimi që maksimizojnë përdorimin e të dhënave të vrojtueshme dhe minimizojnë përdorimin e të dhënave jo të vrojtueshme. Teknika e zgjedhur përmbledh të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do të marrin në konsideratë për përcaktimin e çmimit të një transaksioni.

Fondi mat vlerën e drejtë duke përdorur hierarkinë e mëposhtme të vlerave të drejta që pasqyrojnë rëndësinë e përdorimit të faktorëve në këto matje:

- Niveli 1: Faktorë që janë të kuotuar me çmime tregu në tregje aktive të instrumenteve identike
- Niveli 2: Faktorë të tjerë nga ato të kuotuar me çmime tregu sipas Nivelit 1, dhe që janë të vëzhgueshëm ose drejtpërdrejtë (nëpërmjet çmimeve) ose jo në mënyre të drejtpërdrejte (nëpërmjet çmimeve të përcaktuara).
- Niveli 3: Faktorë që janë të pavëzhgueshëm. Në këtë kategori përfshihen të gjithë instrumentet financiare për të cilët teknikat e vlerësimit përfshijnë faktorë që nuk bazohen në të dhëna të vëzhgueshme dhe të cilët kanë një ndikim të rëndësishëm në vlerësimin e instrumentit.

**Instrumentet financiare jo me vlerë të drejtë**

Instrumentet financiare që nuk maten me VDFH përfshijnë:

- Paraja dhe ekuivalentet e saj, detyrime të tjera. Këto janë aktive financiare dhe detyrime financiare afatshkurtra, vlera kontabël e të cilave është afërsisht e njëjtë me vlerën e drejtë, për shkak të natyrës së tyre afatshkurtër si edhe cilësinë e lartë të aftësisë paguese së tyre; dhe
- Aktivet neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave. Fondi lëshon dhe ripaguan në rutinën e tij kuotat e mbajtësve në një shumë që është e njëjtë me pjesën e tyre në aktivet neto të Fondit në kohën që ato tërhiqen, dhe llogariten mbi bazë konsistente me atë të përdorur në pasqyrat financiare. Rrjedhimisht, vlera kontabël e aktiveve neto që i atribuohen kuotambajtësve është afërsisht e njëjtë me vlerën e drejtë.

**iv. Matja e vlerës së amortizuar**

“Kostoja e amortizuar” e aktiveve financiare ose detyrimeve financiare është shuma në të cilën aktivi financiar ose detyrimi financiar matet në njohjen fillestare pasi janë zbritur ripagesat e principalit, ose amortizimi i akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për ndonjë diferencë midis vlerës fillestare dhe vlerës në maturim, dhe për aktivet financiare të rregulluar për ndonjë zhvlerësim.

**ALBSIG INVEST SHA**  
**FONDI I INVESTIMIT ALBSIG STANDARD**

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025  
(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

**3. Politikat kontabël te rëndësishme (vazhdim)**

**v. Zhvlerësimi**

Fondi njeh një zhvlerësim për humbjet e pritshme të kredisë (“HPK”) për aktivet financiare të njohura me koston e amortizuar. Për të përcaktuar nëse rreziku i kredisë për një aktiv financiar është rritur në mënyrë të rëndësishme që prej njohjes fillestare të tij, dhe kur vlerëson HPK, Fondi merr parasysh informacionet mbështetëse dhe të arsyeshme dhe që janë relevante dhe të gatshme pa shume kosto dhe punë shtesë. Kjo përfshin analizim të informacionit cilësor dhe sasior, duke u bazuar në historikun dhe eksperiencën e Fondit si edhe duke përfshire informacione të cilat i përkasin të ardhmes. Fondi supozon se rreziku i kredisë të një aktivi financiar rritet në mënyrë të rëndësishme në rast se ai shfaqet më shumë se 30 ditë në vonesë.

Fondi konsideron si aktive financiare me rrezik të ulët në rastet kur rreziku i kredisë të kundërpartisë është i listuar si BBB+ nga agjenci të mirënjohura të vlerësimit si Standard and Poor’s, ose kur aktivet financiare lëshohen nga Qeveria Shqiptare ose nga Banka e Shqipërisë.

Fondi nuk ka identifikuar dhe njohur zhvlerësim për aktivet financiare më 31 dhjetor 2025.

**vi. Ç’regjistrimi**

Një aktiv financiar ç’regjistrohet kur të drejtat kontraktuale mbi flukset e parasë nga aktivi financiar kanë mbaruar, ose kur Fondi transferon të drejtat për të marrë flukset e parasë në një transaksion në të cilin në mënyrë të qenësishme të gjitha rreziqet dhe përfitimet nga pronësia e aktivit financiar janë transferuar ose në të cilin Fondi as nuk ka transferuar dhe as nuk ka mbajtur të gjitha rreziqet dhe përfitimet nga pronësia dhe nuk ushtron kontroll mbi aktivin financiar.

Në njohje të një aktivi financiar, ndryshimi midis vlerës së mbartur të aktivitetit dhe vlerës së dhënë njihet në pasqyrën e fitim humbjes.

**c. Paraja dhe ekuivalentet e saj**

Mjete monetare përfshijnë mjete monetare në llogari rrjedhëse në banka dhe mjete të tjera likuide me maturitet jo më shumë se tre muaj nga data e mbajtjes të cilat mund të jenë subjekt i ndryshimeve jo të rëndësishme në vlerën e tregut dhe që përdoren nga Fondi në menaxhimin e angazhimeve afatshkurtra.

**d. Të ardhura dhe shpenzime nga interesi**

Të ardhura dhe shpenzime nga interesi të paraqitura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përfshijnë interesin mbi aktivet financiare dhe detyrimet financiare të matur me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Interesi efektiv llogaritet në njohjen fillestare të një instrumenti financiar si norma që skanton flukset e ardhshme të pagueshme ose të arkëtueshme përgjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar në:

- vlerën bruto të aktivitetit financiar; ose
- vlerën me kosto të amortizuar të detyrimit financiar.

Në llogaritjen e të ardhurave dhe shpenzimeve nga interesi, metoda e interesit efektiv aplikohet mbi vlerën bruto të aktivitetit (në rast se aktivi nuk është i zhvlerësuar) ose mbi koston e amortizuar të detyrimit financiar.

**ALBSIG INVEST SHA**  
**FONDI I INVESTIMIT ALBSIG STANDARD**

---

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025  
(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

**3. Politikat kontabël të rëndësishme (vazhdim)**

**e. Shpenzime nga tarifa dhe komisione**

Shpenzime nga tarifa dhe komisione janë njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përgjatë kohës së kryerjes së shërbimit.

**f. Tarifa për Shoqërinë Administruese**

Fondi duhet ti paguajë Shoqërisë Administruese një tarifë prej 1% të aktiveve neto, e cila njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përgjatë kohës së kryerjes së shërbimit.

**g. Fitimi neto nga instrumentet financiare me VDFH**

Fitim humbja neto nga instrumentet financiare me VDFH përfshin të gjithë ndryshimet në vlerën e drejtë të realizuara ose jo si edhe diferencat nga kursi i këmbimit si edhe të ardhurat nga interesat.

Fitim/humbjet e përealizuara njihen si ndryshimi midis kostos dhe vlerës së drejtë të një instrumenti. Kur instrumenti shitet, vlera e përealizuar e fitimit ose humbjes transferohet në fitimet ose humbjet e realizuara të periudhës.

**h. Vlera neto e aktiveve të Fondit**

Vlera neto e aktiveve të Fondit është e barabartë me totalin e aktiveve minus detyrimet e Fondit.

**i. Tatimi mbi fitimin**

Sipas sistemit tatimor në Shqipëri, Fondi është i përjashtuar nga tatimi mbi fitimin.

**j. Vlera e kuotës së Fondit Albsig Standard**

Vlera e kuotës është e barabartë me vlerën e aktiveve neto të Fondit përpjesëtuar me numrin e kuotave në datën e raportimit. Vlera fillestare e kuotës ka qenë e barabartë me 1,000 Lekë, në përputhje me politikën e Fondit.

**k. Detyrime të shitjes së kuotave**

Në momentin e kërkesës për shlyerje kuotash nga investitorët, vlera e kuotave regjistrohet si detyrim financiar dhe mbartet si detyrim i pagueshëm në pasqyrën e pozicionit financiar.

**l. Transaksione me palë të lidhura**

Palë të lidhura me Fondin konsiderohen ato palë të cilat kanë një influencë dhe kontroll në vendimet financiare dhe operacionale të Fondit.

**ALBSIG INVEST SHA**  
**FONDI I INVESTIMIT ALBSIG STANDARD**

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025  
(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

**4. Administrimi i rrezikut financiar**

**a. Kuadri për administrimin e rrezikut financiar**

Fondi investon në instrumente financiare në përputhje me strategjinë e tij të investimit. Portofoli i Fondit të investimit përfshin letra me vlerë të Qeverisë Shqiptare. Kështu Fondi është i ekspozuar ndaj këtyre rreziqeve nga instrumentet financiare:

- rreziku i kredisë;
- rreziku i likuiditetit;
- rreziku i tregut; dhe
- rreziku operacional.

**b. Rreziku i kredisë**

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare të Fondit nëse një klient ose një palë tjetër e një instrumenti financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet e tij kontraktuale, pjesërisht ose plotësisht gjë që sjell efekt negativ në aktivet e Fondit.

Politika e Fondit mbi rrezikun e kredisë është minimizimi i ekspozimit të tij ndaj palëve të cilat janë të perceptuara si me rrezik të lartë, dhe të ketë marrëdhënie vetëm me palë të cilat përmbushin standardet e kredisë sipas politikës së investimit të Fondit.

Rreziku i kredisë për investimet në Bono dhe Obligacione të Qeverisë Shqiptare, lidhet ngushtësisht me aftësinë paguese të Qeverisë Shqiptare. Rreziku i kredisë tradicionalisht është vlerësuar si i ulët për letrat me vlerë të qeverisë krahasuar me letra të tjera me vlerë.

Të gjitha veprimet kryhen nëpërmjet Bankës Depozitare, e cila është e miratuar nga AMF.

Investimet e Fondit janë detajuar si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2025</b>	<b>31 dhjetor 2024</b>
Obligacione qeveritare*	251,047,718	224,866,665
Obligacione të shoqërive	10,252,660	10,349,155
<b>Totali</b>	<b>261,300,378</b>	<b>235,215,820</b>

\*Qeveria Shqiptare vlerësohet si BB, e qëndrueshme, bazuar në vlerësimin e kreditit të Standard & Poor's dhe B1 e qëndrueshme, bazuar në vlerësimin e kreditit të Moody's.

**c. Rreziku i likuiditetit**

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Fondi mund të mos jetë në gjendje të gjenerojë burime të mjaftueshme monetare për të shlyer plotësisht detyrimet e tij ose mund t'i shlyejë në kushte të cilat janë materialisht jo të favorshme.

Politika e Fondit në menaxhimin e likuiditetit është të sigurojë, sa të jetë e mundur, se gjithmonë do të ketë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet kur është e nevojshme, nën kushte normale dhe tensioni, duke përfshirë edhe shlyerjet e vlerësuara të kuotave, pa shkaktuar papranueshmëri humbje ose duke rrezikuar dëmtimin e reputacionit të Fondit. Aktivet financiare të Fondit përfshijnë Bono Thesari dhe Obligacione të Qeverisë Shqiptare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes dhe pësha e tyre do ndryshojë në varësi të kushteve të tregut si edhe politikës dhe strategjisë së investimit të Shoqërisë Administruese.

**ALBSIG INVEST SHA**  
**FONDI I INVESTIMIT ALBSIG STANDARD**

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025  
(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

**4. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

Shoqëria Administruese sipas rregullores nr.106, datë 30 qershor 2021, duhet të mbajë si asete likuide me cilësi të lartë (ALCL) vlerën më të madhe midis të 10% të aseteve neto të fondit, ose vlerën bruto të flukseve dalëse kumulative të tre muajve të fundit deri në datën e llogaritjes. Asetet me likuiditet të lartë konsiderohen paraja dhe ekuivalentet e saj ose depozita me maturitet më të vogël se 7 ditë apo bono apo obligacione të qeverisë shqiptare që maturohen brenda 1 muaji.

Aktivitet dhe detyrimet financiare sipas maturitetit të tyre më 31 dhjetor 2025 dhe 31 dhjetor 2024 janë si vijon:

Aktivitet	31 dhjetor 2025	Më pak se 1 muaj	1-3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-5 vjet	>5 vjet
Paraja dhe ekuivalentet e saj	34,020,574	34,020,574	-	-	-	-	-
Aktive financiare me VDFH	261,300,378	-	13,374,490	-	-	94,247,309	153,678,579
<b>Totali</b>	<b>295,320,952</b>	<b>34,020,574</b>	<b>13,374,490</b>	-	-	<b>94,247,309</b>	<b>153,678,579</b>
<b>Detyrimet</b>							
Të pagueshme ndaj Shoqërisë Administruese	248,969	248,969	-	-	-	-	-
Të pagueshme ndaj Bankës Depozitare	42,325	42,325	-	-	-	-	-
Detyrime të tjera	168,490	168,490	-	-	-	-	-
<b>Totali</b>	<b>459,784</b>	<b>459,784</b>	-	-	-	-	-
<b>Pozicioni neto</b>	<b>294,861,168</b>	<b>33,560,790</b>	<b>13,374,490</b>	-	-	<b>94,247,309</b>	<b>153,678,579</b>

Aktivitet	31 dhjetor 2024	Më pak se 1 muaj	1-3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-5 vjet	>5 vjet
Paraja dhe ekuivalentet e saj	29,538,145	29,538,145	-	-	-	-	-
Aktive financiare me VDFH	235,215,820	-	3,539,130	-	-	96,811,360	134,865,330
<b>Totali</b>	<b>264,753,965</b>	<b>29,538,145</b>	<b>3,539,130</b>	-	-	<b>96,811,360</b>	<b>134,865,330</b>
<b>Detyrimet</b>							
Të pagueshme ndaj Shoqërisë Administruese	223,182	223,182	-	-	-	-	-
Të pagueshme ndaj Bankës Depozitare	37,941	37,941	-	-	-	-	-
Detyrime të tjera	168,118	168,118	-	-	-	-	-
<b>Totali</b>	<b>429,241</b>	<b>429,241</b>	-	-	-	-	-
<b>Pozicioni neto</b>	<b>264,324,724</b>	<b>29,108,904</b>	<b>3,539,130</b>	-	-	<b>96,811,360</b>	<b>134,865,330</b>

**Aktivitet likuide të cilësisë së lartë (“ALCL”)**

Në përputhje me kërkesat e rregullores numër 106, date 30 qershor 2021, të publikuar nga AMF, ALCL të Fondit më 31 dhjetor 2025 janë në vlerën 12.91% të aktiveve neto, (31 dhjetor 2024: 12.40%), vlerë e cila është mbi minimumin e kërkuar nga rregullorja prej 10% të aktiveve neto të fondit ose vlerën bruto të flukseve dalëse kumulative të tre muajve të fundit deri në datën e llogaritjes.

Fondi mban një nivel aktivesh likuide prej të paktën 10% të totalit të aktiveve, në para dhe ekuivalente të saj, si edhe letra me vlerë me afat të shkurtër, në varësi të kushteve të tregut dhe në përputhje me strategjinë e investimit të Fondit.

**ALBSIG INVEST SHA**  
**FONDI I INVESTIMIT ALBSIG STANDARD**

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025  
(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

**4. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

**Prova e rezistencës**

Fondi kryen prova të rezistencës bazuar në disa skenarë, duke përfshirë si lëvizjet në normat e interesit ashtu edhe tërheqjen e kuotave nga Fondi, për të përllogaritur efektet e mundshme mbi përfitueshmërinë e Fondit si edhe nevojat për likuiditet në kushte të tensionuara të tregut.

Fondi është i ekspozuar ndaj rritjeve në normat e interesit krahasuar me situatën aktuale, pasi kjo sjell një ulje të vlerës së instrumentit që mbahet me vlerën e drejtë. Janë konsideruar disa skenarë të mundshëm për lëvizjen e normave afatshkurtër dhe afatgjatë të interesit.

Bazuar në këto supozime të përdorur në skenarët, është vlerësuar se Fondi mund të administrojë qëndrueshëm edhe në kushtet e vështira të supozuara, ndërkohë që mund ti përmbahet edhe detyrimeve rregullatore për likuiditetin si edhe detyrimeve për tërheqje.

Bazuar në analizën e mësipërme Këshilli i Administrimit është i bindur se nuk ka pasiguri materiale, të cilat mund të krijojnë dyshime të rëndësishme në aftësinë e Fondit për vijueshmërinë. Si rrjedhojë pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e vijueshmërisë.

**d. Rreziku i tregut**

Rreziku i tregut zhvillohet si pasojë e ndryshimeve në:

- a) normat e interesit,
- b) kurset e këmbimit.

Rritja e normave të interesit sjell ulje të vlerës së instrumentit financiar, dhe ulja e normave sjell rritje të vlerës së instrumentit financiar. Si rrjedhojë e ndryshimeve në normat e interesit investitori në periudha afatshkurtra mund të pësojë humbje të pjesshme të kapitalit. Por një veçori e e bonove dhe obligacioneve është se nëse emetuesi i tyre nuk falimenton, investitori do të sigurojë një normë kthimi të barabartë me normën e kuponit vetëm nëse ai e mban bonon apo obligacionin deri në maturim. Shoqëria Administruese, menaxhon rrezikun nga normat e interesit me anë të strategjive të menaxhimit të kohëzgjatjes (duration) duke menaxhuar “key rate duration”, që do të thotë duke rritur ose zvogëluar kohëzgjatjen e tyre në varësi të kushteve të tregut dhe duke vendosur limite mbi këto “key rate durations”. Kufiri i kohëzgjatjes mesatare të fondit do të jetë më e vogël ose e barabartë me 5 vjet. Luhatjet e kursit të këmbimit sjellin luhatje të vlerës së aktiveve të konvertuar në monedhën vendase, Lek. Fondi nuk ka parashikuar që të shpërndajë aktive në monedhë të huaj.

Tabela e mëposhtme paraqet ndikimin mbi të ardhurat neto nga interesi në Lek, si pasojë e ndryshimit në normën e interesit prej +/-100bp për portofolin e letrave me vlerë me të ardhura fikse:

	<b>31 dhjetor 2025</b>	<b>31 dhjetor 2024</b>
Skenari	Efekti në fitim/(humbje)	Efekti në fitim/(humbje)
<b>+/- 100bp</b>	<b>+/-11,971,363</b>	<b>+/-11,418,828</b>

**e. Rreziku operacional**

‘Rreziku operacional’ është rreziku i pësimit të një humbjeje direkte ose jo-direkte që mund të lindë si pasojë e një sërë shkaqesh që shoqërojnë procese të tilla si teknologjia dhe infrastruktura që mbështet veprimtarinë e Fondit me instrumentet financiare, qoftë së brendshmi në Fond apo së jashtmi me ata që i ofrojnë shërbime Fondit, dhe nga faktorë të jashtëm të tjerë nga rreziku i kredisë, i tregut apo i likuiditetit, të tillë si ato që lindin nga kërkesat ligjore dhe rregullatore dhe standardet e gjithëpranuara të sjelljes së investimeve.

**ALBSIG INVEST SHA**  
**FONDI I INVESTIMIT ALBSIG STANDARD**

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025  
(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

**4. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

Qëllimi i Fondit është të administrojë rrezikun operacional në mënyre të tillë që të baraspeshojë kufizimet në humbje financiare dhe dëmtimit të reputacionit me arritjen e qëllimit të investimeve për të prodhuar kthim ndaj investitorëve. Aktivet e Fondit ruhen nga Banka Depozitare që është Banka e Tiranës.

Shoqëria e Administrimit të Fondit ka krijuar një sistem të kontrollit të brendshëm dhe procedurat për të parandaluar rrezikun e humbjeve të Fondit të shkaktuara nga gabimet njerëzore ose të sistemit. Për shkak të proceseve joadekuate të brendshme, për shkak të gabimeve të dokumentacionit, si dhe për shkak të procedurave të tregtimit, vlerësimit dhe pagesave në emër të Fondit. Shoqëria administron Fondin përmes një sistemi operativ i cili është ndërtuar duke respektuar parimin 4 (katër) sy. Gjithashtu, Banka e Depozituesve luan një funksion kontrolli mbi aktivitetin e investimeve dhe transaksioneve me anëtarët e fondit (investimet dhe shlyerjet).

**5. Paraja dhe ekuivalentet e saj**

Paraja dhe ekuivalentet e saj maten me koston e amortizuar në pasqyrat financiare dhe përbëhen si vijon:

	<b>31 dhjetor 2025</b>	<b>31 dhjetor 2024</b>
Llogari rrjedhëse në bankë	18,245	35,922
Depozita me afat maturimi deri në tre muaj	34,000,000	29,500,000
Interesi i përlogaritur	2,329	2,223
<b>Totali</b>	<b>34,020,574</b>	<b>29,538,145</b>

Në 2025, depozita afatshkurtër konsiston në një depozitë të vendosur pranë Bankës së Tiranës me vlerë prej 24.000.000,00 Lekë, me normë interesi prej 2,50% dhe maturim deri më 08 janar 2026.

Në 2024, depozita afatshkurtër konsiston në një depozitë të vendosur pranë Bankës së Tiranës me vlerë prej 29.500.000,00 Lekë, me normë interesi prej 2,75% dhe maturim deri më 07 janar 2025.

**6. Aktive financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes**

Aktive financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes përbëhen nga letrat me vlerë të Qeverisë Shqiptare dhe të shoqërive.

	<b>31 dhjetor 2025</b>	<b>31 dhjetor 2024</b>
Obligacione qeveritare*	251,047,718	224,866,665
Obligacione të shoqërive	10,252,660	10,349,155
<b>Totali</b>	<b>261,300,378</b>	<b>235,215,820</b>

**ALBSIG INVEST SHA**  
**FONDI I INVESTIMIT ALBSIG STANDARD**

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025  
 (Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

**6. Aktive financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes (vazhdim)**

Vlera e drejtë e aktiveve financiare është si vijon:

<b>31 dhjetor 2025</b>	<b>Çmimi i blerjes</b>	<b>Interes i përlogaritur</b>	<b>Fitim/ (humbje) nga vlera e drejtë</b>	<b>Vlera e drejtë</b>
Obligacione qeveritare	253,255,982	4,863,651	3,180,745	261,300,378
	<b>253,255,982</b>	<b>4,863,651</b>	<b>3,180,745</b>	<b>261,300,378</b>

<b>31 dhjetor 2024</b>	<b>Çmimi i blerjes</b>	<b>Interes i përlogaritur</b>	<b>Fitim/ (humbje) nga vlera e drejtë</b>	<b>Vlera e drejtë</b>
Obligacione qeveritare	215,738,356	4,385,067	15,092,397	235,215,820
	<b>215,738,356</b>	<b>4,385,067</b>	<b>15,092,397</b>	<b>235,215,820</b>

Në kushtet e një tregu jo-aktiv të bonove dhe obligacioneve të thesarit të emetuar nga Shteti Shqiptar, shoqëria përdor një metodologji për vlerësimin e këtyre asetëve sipas vlerës së drejtë. Kjo metodologji është dakordësuar me bankën depozitare dhe është depozituar në AMF. Metodologjia interpolon në mënyrë lineare normat e interesit të ankandëve më të fundit për të përcaktuar çmimin e një obligacioni ose bono thesari.

**7. Të pagueshme ndaj Shoqërisë Administruese**

Të pagueshme në vlerën 248,969 Lek janë detyrime ndaj Shoqërisë Administruese më 31 dhjetor 2025 (2024: 223,182 Lek).

**8. Të pagueshme ndaj Bankës Depozitare**

Të pagueshme në vlerën 42,325 Lek janë detyrime ndaj Bankës Depozitare më 31 dhjetor 2025 (2024: 37,941 Lek).

**9. Detyrime të tjera**

	<b>31 dhjetor 2025</b>	<b>31 dhjetor 2024</b>
Detyrime ndaj Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare	12,489	11,177
Detyrime ndaj eksperteve	156,001	156,000
Detyrime të tjera	-	941
<b>Totali</b>	<b>168,490</b>	<b>168,118</b>

**ALBSIG INVEST SHA**  
**FONDI I INVESTIMIT ALBSIG STANDARD**

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025  
(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

**10. Të ardhura nga shitja e instrumenteve financiare neto**

	<b>31 dhjetor 2025</b>	<b>31 dhjetor 2024</b>
Të ardhura nga shitja e Obligacioneve Qeveritare	-	14,945
<b>Totali</b>	<b>-</b>	<b>14,945</b>

Humbja e nga shitja e instrumenteve financiare paraqitet s me poshtë:

	<b>31 dhjetor 2025</b>	<b>31 dhjetor 2024</b>
Humbje të realizuara nga obligacionet qeveritare	(191,562)	(258,262)
<b>Totali</b>	<b>(191,562)</b>	<b>(258,262)</b>

**11. Të ardhura nga interesi të llogaritura duke përdorur metodën e interesit efektiv**

	<b>31 dhjetor 2025</b>	<b>31 dhjetor 2024</b>
Të ardhura interesi nga letrat me vlerë të qeverisë	11,194,272	11,374,175
Të ardhura interesi nga letrat me vlerë të shoqërive	800,000	800,000
Të ardhura interesi nga depozitat	1,042,894	1,096,384
<b>Totali</b>	<b>13,757,166</b>	<b>13,270,559</b>

**12. Tarifa e Shoqërisë së Administrimit**

Tarifa e Shoqërisë së Administrimit në vlerën prej 2,850,401 Lek (2024: 2,575,205 Lek) përfaqëson shpenzimin e ndodhur përgjatë periudhës dhe përllogaritet si 1% (në bazë vjetore) e vlerës neto të aktiveve. Ky shpenzim përllogaritet në bazë ditore.

**13. Tarifa e Bankës Depozitare**

Tarifa e Bankës Depozitare përbehet si vijon:

	<b>31 dhjetor 2025</b>	<b>31 dhjetor 2024</b>
Komisione për blerje letra me vlerë	25,358	40,611
Tarifa e Bankës Depozitare	484,568	437,785
<b>Totali</b>	<b>509,926</b>	<b>478,396</b>

Banka e Tiranës është banka depozitare e Fondit.

**ALBSIG INVEST SHA**  
**FONDI I INVESTIMIT ALBSIG STANDARD**

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025  
(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

**14. Shpenzime të tjera**

	<b>31 dhjetor 2025</b>	<b>31 dhjetor 2024</b>
Tarifa AMF	142,844	129,397
Shpenzime të tjera	156,000	156,000
Shpenzime taksa	6	5
<b>Totali</b>	<b>298,850</b>	<b>285,402</b>

**15. Ngjarje mbas datës së raportimit**

Nuk ka ngjarje të tjera pas datës së raportimit që mund të kërkojë rregullim apo pasqyrim të informacionit në pasqyrat financiare të Fondit.

**ALBSIG INVEST SHA**  
**FONDI I INVESTIMIT ALBSIG STANDARD**

Skedulet Suplementare

**Skedulet Suplementare**

**Pasqyra e indikatorëve specifik për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025 dhe 31 dhjetor 2024**

	<b>31 dhjetor 2025</b>	<b>31 dhjetor 2024</b>
Aktivet neto	294,861,168	264,324,724
Numri i kuotave	243,946	229,400
Aktivet neto ndaj një kuotë	1,209	1,152
Numri i kuotave në fillim të periudhës	229,400	239,495
Numri i kuotave në Fond	24,222	14,635
Numri i kuotave të tërhequra nga Fondi	(9,676)	(24,730)
Numri i kuotave në fund të periudhës	243,946	229,400
Raporti ndërmjet kostos dhe aktiveve neto mesatare	1.2836	1.3003
Raporti ndërmjet të ardhurave neto dhe aktiveve neto mesatare	4.5919	9.7038
Raporti i investimit	4.9011	10.1571
<b>Vlera minimale e aktiveve neto për kuotë</b>	<b>1,152</b>	<b>1,046</b>
<b>Vlera maksimale e aktiveve neto për kuotë</b>	<b>1,218</b>	<b>1,152</b>
<b>Vlera minimale e aktiveve neto</b>	<b>264,352,688</b>	<b>249,899,119</b>
<b>Vlera maksimale e aktiveve neto</b>	<b>294,869,123</b>	<b>264,331,939</b>

**Struktura e investimeve më 31 dhjetor 2025**

<b>Përshkrimi</b>	<b>Shënime</b>	<b>Vlera Nominale</b>	<b>Kosto e blerjes</b>	<b>Vlera kontabël</b>	<b>% në asetet totale të Fondit</b>
Obligacione qeveritare	6	233,500,000	242,922,382	251,047,718	85.01%
Obligacione të shoqërive	6	10,000,000	10,333,600	10,252,600	3.47%
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	5	-	-	34,020,574	11.52%
<b>TOTAL</b>		<b>243,500,000</b>	<b>253,255,982</b>	<b>295,320,952</b>	<b>100%</b>

**ALBSIG INVEST SHA**  
**FONDI I INVESTIMIT ALBSIG STANDARD**

Skedulet Suplementare

**16. Skedulet Suplementare (vazhdim)**

**Struktura e investimeve më 31 dhjetor 2025 (vazhdim)**

Tipi	Vlera nominale	Kosto e prokurimit	Vlera në datën e raportimit	% në asetet totale të fondit
Obligacione qeveritare (brenda vendit)-tregu primar	154,300,000	161,476,134	167,813,696	57%
Obligacione të shoqërive (brenda vendit)-tregu primar	10,000,000	10,333,600	10,252,660	3%
Bono thesari (brenda vendit)-tregu primar	-	-	-	-
<b>Totali i tregut primar</b>	<b>164,300,000</b>	<b>171,809,734</b>	<b>178,066,356</b>	<b>60%</b>
Obligacione qeveritare (brenda vendit)-tregu sekondar	79,200,000	81,446,248	83,234,022	28%
Obligacione të shoqërive (brenda vendit)-tregu sekondar	-	-	-	0.0%
Bono thesari (brenda vendit)-tregu sekondar	-	-	-	-
<b>Totali i tregut sekondar</b>	<b>79,200,000</b>	<b>81,446,248</b>	<b>83,234,022</b>	<b>28%</b>
<b>TOTAL</b>	<b>243,500,000</b>	<b>253,255,982</b>	<b>261,300,378</b>	<b>88%</b>

**Struktura e investimeve më 31 dhjetor 2024**

Përshkrimi	Shënime	Vlera Nominale	Kosto e blerjes	Vlera kontabël	% në asetet totale të Fondit
Obligacione qeveritare	6	210,900,000	206,031,945	224,866,665	84.93%
Bono thesari	6	10,000,000	9,706,411	10,349,155	3.91%
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	5	-	-	29,538,145	11.16%%
<b>TOTAL</b>		<b>220,900,000</b>	<b>215,738,356</b>	<b>264,753,965</b>	<b>100%</b>

Tipi	Vlera nominale	Kosto e prokurimit	Vlera në datën e raportimit	% në asetet totale të fondit
Obligacione qeveritare (brenda vendit)-tregu primar	144,200,000	140,076,432	154,710,540	58%
Bono thesari (brenda vendit)-tregu primar	10,000,000	9,706,411	10,349,155	4%
<b>Totali i tregut primar</b>	<b>154,200,000</b>	<b>149,782,843</b>	<b>165,059,695</b>	<b>62%</b>
Obligacione qeveritare (brenda vendit)-tregu sekondar	66,700,000	65,955,513	70,156,125	27%
Bono thesari (brenda vendit)-tregu sekondar	-	-	-	0%
<b>Totali i tregut sekondar</b>	<b>66,700,000</b>	<b>65,955,513</b>	<b>70,156,125</b>	<b>15%</b>
<b>TOTAL</b>	<b>220,900,000</b>	<b>215,738,356</b>	<b>235,215,820</b>	<b>89%</b>

**ALBSIG INVEST SHA**  
**FONDI I INVESTIMIT ALBSIG STANDARD**

Skedulet Suplementare

**16. Skedulet Suplementare (vazhdim)**

**Pasqyra e fitimit / humbjes së realizuar deri më 31 dhjetor 2025**

<b>Instrumente të shitura</b>	<b>Vlera Nominale</b>	<b>Vlera kontabël/ e drejtë</b>	<b>Vlera e shitjes</b>	<b>Fitim/humbje e realizuar</b>
Obligacione qeveritare	17,000,000	17,329,204	17,137,643	(191,562)
<b>Total</b>	<b>17,000,000</b>	<b>17,329,204</b>	<b>17,137,643</b>	<b>(191,562)</b>

**Pasqyra e fitimit / humbjes së realizuar deri më 31 dhjetor 2024**

<b>Instrumente të shitura</b>	<b>Vlera Nominale</b>	<b>Vlera kontabël/ e drejtë</b>	<b>Vlera e shitjes</b>	<b>Fitim/humbje e realizuar</b>
Obligacione qeveritare	47,700,000	48,521,066	48,277,748	(243,318)
<b>Total</b>	<b>47,700,000</b>	<b>48,521,066</b>	<b>48,277,748</b>	<b>(243,318)</b>

**Pasqyra e fitimit / humbjes së porealizuar deri më 31 dhjetor 2025**

<b>Instrumente financiare</b>	<b>Vlera e blerjes</b>	<b>Vlera në datën e raportimit</b>	<b>Ndryshimi në vlerën e drejtë të aktiveve financiare</b>
Obligacione qeveritare -tregu primar	161,476,134	164,398,963	2,922,829
Obligacione të shoqërive	10,333,600	10,237,104	-96,496
Obligacione qeveritare -tregu sekondar	81,446,248	81,800,660	354,412
<b>Total obligacione qeveritare</b>	<b>253,255,982</b>	<b>256,436,727</b>	<b>3,180,745</b>
Bono Thesari -tregu sekondar	-	-	-
<b>Total Bono Thesari</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Total fitim/humbje e porealizuar</b>	<b>253,255,982</b>	<b>256,436,727</b>	<b>3,180,745</b>

**Pasqyra e fitimit / humbjes së porealizuar deri më 31 dhjetor 2024**

<b>Instrumente financiare</b>	<b>Vlera e blerjes</b>	<b>Vlera në datën e raportimit</b>	<b>Ndryshimi në vlerën e drejtë të aktiveve financiare</b>
Obligacione qeveritare -tregu primar	140,076,432	151,489,340	11,412,908
Obligacione të shoqërive	9,706,411	10,333,600	627,189
Obligacione qeveritare -tregu sekondar	65,955,513	69,007,813	3,052,300
<b>Total obligacione qeveritare</b>	<b>215,738,356</b>	<b>230,830,753</b>	<b>15,092,397</b>
Bono Thesari -tregu sekondar	-	-	-
<b>Total Bono Thesari</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Total fitim/humbje e porealizuar</b>	<b>215,738,356</b>	<b>230,830,753</b>	<b>15,092,397</b>